

ANULLIME ANKANDI

BASHKIA LUSHNJE NJOFTIM ANULLIM ANKANDI

11. Autoriteti shitës: Bashkia Lushnje

Adresa: Lagjia :” Kongresi i Lushnjes “ Lushnje

Tel/Fax: + 355 35 221 39

E-mail: bashkia_lushnje@yahoo.com

Adresa e Internetit: www.bashkialushnje.gov.al

2. Data e zhvillimit të ankandit: 01/09/2025 ora: 10.00

3. Lloji i Procedurës standarde te ankandit: Proçedurë e hapur

4. Objekti i Shitjes: “Shitje me ankand të aksioneve të Klubit të Futbollit Lushnja 1930 sh.a, në masën 100%”.

5. Përshkrim i shkurtër i objektit te shitjes:

KLUBI I FUTBOLLIT LUSHNJA 1930 sh.a është krijuar më 06.09.2013 me Vendim Nr.60 të Këshillit të Bashkisë Lushnje, si një shoqëri aksionare me ofertë private. KLUBI I FUTBOLLIT LUSHNJA 1930 sh.a ka selinë në Lagjia “Xh.Nepravishta” në stadiumin Roza Haxhiu, Lushnje.

Futbolli ka një histori suksesi 94-vjeçare për Qytetin e Lushnjes. Klubi Futbollit Lushnja (KF Lushnja) u themelua më 27 korrik 1930 në Lushnje. Aksionet zotërohen 100% nga Bashkia Lushnje

Objekti i aktivitetit të Shoqërisë KLUBI I FUTBOLLIT LUSHNJA 1930 sh.a është: Organizimi i aktiviteteve sportive te fubollit; krijimi i ekipeve zinxhir dhe pjesëmarrja në garat sportive të organizuara nga Federata Shqiptare e Futbollit; aderimi dhe regjistrimi si klub në Federatën Shqiptare të Futbollit dhe në të gjitha llojet e aktiviteteve të futbollit kombëtare dhe ndërkombëtare; Futja në tregun e lojtarëve për të blerë lojtarë sipas nevojave të ekipit; aktivitete të tjera në fushën e futbollit për interesat e shoqërisë; Shoqëria,brenda kufijve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi, do të kryejë çdo operacion tregtar dhe financiar që lidhet drejtpërdrejtë ose tërthorazi me objektin e saj.

6. Vlera e ankandit: Vlera e ankandit është 11 261 652,80 (njëmbëdhjetë milion e dyqind e gjashtëdhjetë e një mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e dy presje tetëdhjetë) Lekë.

Vlera fillestare e ankandit ishte 14 077 066 (katërmbëdhjetë milion e shtatëdhjetë e shtatë mijë e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë.

Objekti i Ankandi është shpallur dy herë për shitje , por në asnjë nga të dyja herët, nuk është paraqitur asnjë ofertë për blerjen e tij.

Në zbatim të VKM -së nr.1719 dt.17.12.2008 “Për miratimin e rregullave të ankandit publik” të ndryshuar, Kreu VI Kushte të Përgjithshme për zbatim , pika 6 ,Mungesa e Konkurrencës , shkronja c, Autoriteti shitës bëri ndryshimin e vlerës në masën 20%.

7. Vendi i zhvillimit te ankandit: (Adresa:) Salla e mbledhjeve kati 2, Bashkia Lushnje.

8. Arsyet e Anullimit: Në zbatim të ligjit nr.9874, datë 14.02.2008 “Për ankandin Publik”, të ndryshuar si dhe te VKM-së nr. 1719, datë 17.12.2008 " Për miratimin e rregullave të ankandit publik", të ndryshuar, Kreu VI, Kushte të përgjithshme për zbatim, pika 6 Mungesa e konkurrencës, shkronja a:

a) Që të vazhdojë procesi i përzgjedhjes së fituesit në vijim të procedurës së hapur, me përzgjedhje të blerësve duhet të pranohet të paktën 1 (një) ofertë e vlefshme. Në të kundërt, autoriteti shitës ndërpret procedurën dhe fillon një procedurë të re, dhe, nëse kjo dështon përsëri, zbaton procedurën e parashikuar në nenin 20 të LAP-së, nëse ekzistojnë rrethana të tilla.

b) ;

c) ;

ç) ;

d) ;

f) ;

Etj. _____

9. Informacione shtesë

Data e shpërndarjes së këtij njoftimi 01.09.2025